

Avokati i Popullit dhe te drejtat e njeriut

1. Avokati i Popullit, si institucion i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, përbën një pjesë integrale të sistemit të kontrollit dhe balancës, i cili është sot një parim bazë i qeverisjes demokratike në të gjithë botën.
2. Avokati i Popullit përfaqëson një eksperience të re për vendin, dhe duket paksa paradoksale për mentalitetin e një shoqërie, e cila ende vazhdon të barazojë shtetin me ekzekutivin, që forca tipike e këtij institucioni mbetet tek rekomandimi, apo propozimi që, ai mund t'i drejtojë organeve të administratës publike.
3. Institucionet e krijuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë aktorë të rëndësishëm shtetformues në sistemet demokratike. Ombudsmani si njëri prej tyre, luan rol të pazëvendësueshëm, duke qenë tregues i shkallës së pjekurisë të klasës politike dhe të mentalitetit të shoqërisë që e krijon atë.



Krijimi i Ombudsmanit në Shqipëri

- ▶ Modeli i Ombudsmanit klasik parlamentar, i bazuar në konceptin e ndarjes së pushteteve të formuluar nga Monteskje, përbën bazën e krijimit të ombudsmanëve të sotëm.
- ▶ Ngritja dhe funksionimi i institucionit të Ombudsmanit në Shqipëri përfaqëson përpjekjet për ndërtimin e shtetit të së drejtës, që konsiderohet si mjete me anë të të cilit sistemi i vlerave demokratike depërton në mekanizmat juridike.
- ▶ Krijimi i këtij institucioni në vendin tonë, është përqafuar si ide dhe realizuar konkretisht me parashikimin në Kushtetutën e miratuar në vitin 1998. Ai është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt ose jo në Shqipëri, refugjat, si dhe personat pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike.
- ▶ Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, është organ i administratës publike, ekstra-gjyqësor, lëndë e parë e funksionimit të të cilit janë ankesat dhe kërkesat e qytetarëve, por ai mund të veprojë edhe me iniciativë. Ai është një organ jovendimarrës.
- ▶ Thelbi i filozofisë së veprimit mbetet mbikqyrja për mirëfunksionimin e administratës publike, si oponencë për mirëqeverisje dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Objektivi i përhershëm i tij është që të realizohet transparenca e administratës publike, ashtu siç e kërkon ekologjia e demokracisë. Për këto arsye, Avokati i Popullit bën pjesë në ato institucione, që në përputhje me Parimet e Parisit, janë garante të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut.
- ▶ Duke mos qenë i vetëm në llojin e tij në Shqipëri, Avokati i Popullit duhet të tregojë individualitet të spikatur në rolin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të individit.

Baza ligjore per funksionimin

- ▶ Mungesa e tradites, e kushtëzuar nga një sërë faktorësh politikë, ekonomikë, socialë, si edhe gjeopolitikë, evidenton mungesën e një institucioni të ngjashëm me Ombudsmanin deri në historinë e vonëshme të shtetit shqiptar.
- ▶ Traumata sociale që ndodhën në Shqipëri, gjatë 10 viteve të parë të tranzicionit, dhe mosmenaxhimi i mirë i tyre bënë që mesazhi i komunitetit ndërkombëtar të pranishëm dhe me ndikim të madh në vend të ishte; jo më ndihmë ekonomike për mbijetesë, jo më ndihma financiare të pakushtëzuara ndaj qeverive shqiptare, por programe zhvillimi për ngritjen dhe forcimin e institucioneve të reja demokratike të shtetit shqiptar.
- ▶ Si bazë juridike për krijimin e institucionit Avokatit të Popullit shërbeu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me referendum më 28 Nëntor 1998. Në shkurt të vitit 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i cili deri tani ka pasuar disa ndryshime dhe shtesa.
- ▶ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, parasheh një dimension aktiv në kuadër të promovimit të të drejtave të njeriut, sidomos në veprimtarinë parandaluese në luftën kundër korrupsionit. (Ne nenin 8, thuhet se shtetet pale, kuptuar ketu edhe Ombudsmanin, duhet të promovojnë vlera që përçojnë standarte dhe respektojnë të drejtën për mireadministrim).
- ▶ Ligji organik “Për Avokatin e Popullit”, parashikon se, Avokati i Popullit veç detyrave të caktuara në të, mund të kryejë edhe detyra të tjera, të caktuara në ligje të veçanta.(Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, ose poshtëruës; si dhe institucion i veçantë ku mund të drejtohen ankesat e konsumatorëve, zbatimi i ligjeve pjese e paketes se reformes ne drejtesi).

Juridiksioni, kompetencat dhe mjetet ligjore te Avokatit te Popullit

- ▶ Juridiksion administrativ, mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të individit, kryhet në kuadër të veprimtarisë së administratës publike si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, me përjashtimet e parashikuara në ligj.
- ▶ Kompetencë diskreciale për të filluar shqyrtimin e çështjeve të caktuara “ex-officio”; Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi që e ka kryer atë apo tek organi epror, si dhe i rekomandon prokurorisë fillimin e hetimeve kur konstatohet konsumimi i një vepre penale; U rekomandon organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve; apo t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore, kur ai vëren se është vetë përmbajtja e ligjit apo e akteve të tjera normative e jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut; Pranon ankesa për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe procedurat gjyqësore; Vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve normative, përmbajtja e të cilave përbën premise për shkelje të të drejtave të njeriut; Merr pjesë dhe ndihmon në përgatitjen e raporteve dhe dokumenteve të tjera, të hartuara nga shteti shqiptar, për të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe bashkëpunon me organizatat joqeveritare për marrjen periodikisht të mendimeve të tyre lidhur me gjendjen e të drejtave, si dhe për organizimin e veprimtarive kombëtare për këto qellim; Avokati i Popullit, cilësohet si një subjekt me të drejta të plota për fillimin e një procedimi administrativ, duke marrë pjesë vetë në të, në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjerë që mund të preken nga procedimi administrativ; Përcakton strukturën dhe organikën e zyrës së Avokatit të Popullit.

Mjetet ligjore te Avokatit te Popullit

► Mjetet e reagimit ligjor janë:

Rekomandimi.

Propozimi për shkarkimin e funksionarëve.

Kërkesa për marrje masash disiplinore.

Propozimi për ndryshim apo përmirësim të ligjeve.

Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Kërkesat për t'u dëgjuar në Kuvendin e Shqipërisë për probleme të ndryshme.

Raportet Vjetore dhe ato të veçanta drejtuar Kuvendit të Shqipërisë. Ndërhyrjet “Amicus Curiae” drejtuar gjykatave.

Nga pozicion reaktiv ne proaktiv

- ▶ Pozicioni reaktiv mbeshtetur thelbesisht ne mbrojtje te te drejtave te njeriut.
- ▶ Pozicioni proaktiv mbeshtetur ne parandalim te shkeljeve dhe promovim te te drejtave te njeriut, natyrshem i kombinuar me mbrojtjen e te drejtave te njeriut.
- ▶ Strategjia e Institucionit te Avokatit te Popullit për vitet 2013-2015.